



Republika e Kosovës
Municipality of Istog
Republika Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Republic of Kosovo

Komisioni i Komunës i Aksioneve të “Stacionit të Autobusëve” në Istog, në bazë të dispozitave të nenit 16 të Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, shpall:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Drejtor në Bordin e Drejtorëve në “Stacionin e Autobusëve” në Istog.
Numri i pozitës: 4 (katër) kryerëse
Kohëzgjatja e mandatit : 3 (tri) vjeçare
Vendi i punës: Stacioni i Autobusëve në Istog

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Administron dhe ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarisë së zyrtareve të N.P.L dhe merr vendim për N.P.L “Stacioni i Autobusëve” sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.
- Zgjedh dhe zëvendëson, shkarkon Kryeshefin Ekzekutiv të N.P.L “Stacioni i Autobusëve”
- Aprovon Planin, Raportin e punës dhe Raportin Financiar të N.P.L “Stacioni i Autobusëve” në Istog për periudhat e caktuar kohore dhe njëherit rekomandimet për aprovim këto raporte tek K.K.A dhe Kuvendi i Komunës.
- Miraton dokumente si: Rregulloret e brendshme, skemën organizative dhe sistematizimin e vendeve të punës,
- Propozon Ndërmarrjen e hapave të ndryshëm për administrimin sa më të mirë të N.P.L “Stacioni i Autobusëve”.
- Për punët e veta Bordi i përgjigjet K.K.A dhe Kuvendit të Komunës.

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universitare.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë – në një nivel të lartë të menaxhimit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporatave, financa, menaxhim të thesarit banka, konsulent në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencave ose njohurive e cila ka të bëjë me veprimtarin afariste në N.P ose për së paku 5 vjet të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar ose anëtar i një profesioni tjetër i cili ndërlihet ngushtë me veprimtarin afariste të N.P.
- Drejtori në bordin e Drejtorëve të N.P.L “Stacioni i Autobusëve” duhet të jetë person me integritet të dëshmuar i cili i plotëson kushtet e parapara me dispozitat e nenit 17.1 dhe 17.2 të Ligjit nr.03/L-87 për ndërmarrjet Publike,
- Të ketë shkathhtësi menaxhuese,
- Të ketë njohuri për punën me kompjuter (MS, Word, Exel, etj).
- Njohje e gjuhëve zyrtare e domosdoshme,
- njohja e gjuhëve të huaja dhe punës me kompjuter do të konsiderohet përparësi.

Kandidatet e interesuar për këtë pozitës, kërkesës duhet ti bashkangjitin:

- CV-në
- Certifikata e lindjes,
- Dëshmi të kualifikimeve shkollore,
- Dëshmi mbi përvojën e punës dhe
- Dokument identifikimi,
- Certifikata që nuk është nën hetime , dhe
- Letër motivuese.

Dokumentet e nevojshme dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetar të Komunës së Istogut ose përmes postes.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjete) ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Inkurajohen të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpresim kërkesat nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komisioni Komunal i Aksionarëve
Enver Rugova
Selajdin Bytyqi
Jhonë Haxhijaj